

Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 pika 1 dhe nenit 36 paragrafi 1 pika 14 nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 2/02), Këshilli i Komunës Çair në mbledhjen e 58-të e mbajtur me datë 07.12.2007 solli

## **Plani Aksionar Lokal për çështjen handikap për Komunën Çair 2008-2010**

### **I. Hyrje**

Zhvillimi lokal është temë kryesore e diskutimeve politike kur bëhet fjalë për decentralizimin në Maqedoni. Procesi i decentralizimit në Maqedoni përparon edhe pse ende priten zgjedhje për ndarje të obligimeve dhe kompetencave në nivel lokal dhe qendror. Decentralizimi e ofron pushtetin deri te qytetarët, e bën më të përshtatshëm dhe më të hapur, ndërsa në atë mënyrë më të përgjegjshme për nevojat e njerëzve.

Në përgatitjet e Maqedonisë për hyrje në Bashkimin Evropian shumë me rëndësi është të silltet zgjedhje politike në të cilën do të marrin pjesë pushteti lokal dhe qytetarët duke i përfshirë edhe personat me handikap. Të patjetërsueshme janë reforma komplete që të mundet shteti më mirë të ballafaqohet me nxitjet globale dhe nacionale të natyrës politike, ekonomike dhe sociale.

Suksesi i procesit të decentralizimit do të matet me atë sa kualiteti i jetës dhe qasjes së barabartë deri te mundësitë të cilat i ofron zhvillimi i mjedisit lokal do të përmirësohet. Duke pasur parasysh atë, në procesin e reformave duhet të garantohen minimum standarde, nivele të shërbimeve dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët me ose pa handikap.

Pa marrë parasysh aktivitetet të cilat ndërmerren në nivel nacional, Organizatat e personave me handikap fokusohen në nivel lokal për shkak se në nivelin lokal më së miri zgjidhen problemet. Ata panë se e rëndësishme është të krijohet bazë dhe mjedis i mirë në korniza të komunave të tyre, ku personat me handikap do të ndihen të pavarur dhe të aftë për vetë realizim pa marrë parasysh handikapun e tyre.

Gjatë kohës së tribunave – të mbajtura në periudhën prej muajt tetor 2006 – të cilët bënë fjalë për nevojën e krijimit të strategjisë për çështjen e handikapurit në nivel lokal, doli nevoja e formimit të PLANIT AKSIONAR LOKAL PËR HANDIKAP, i cili e përfshin të drejtën e pjesëmarrjes së të gjithë qytetarëve. Me qëllim që të jetë efektiv ky plan aksionar duhet të jetë i përfshirë në të gjitha nivelet e bashkësisë. Plani aksionar për handikap është plan i veçantë, pavarësisht nga plani i politikës sociale të cilën e udhëheq komuna. I njëjti duhet të funksionojë në kahen të arrihen përmirësime të dukshme të cilat do ti ndiejnë personat me handikap dhe do të munden në mënyrë të barabartë me të gjithë qytetarët të marrin pjesë në shoqëri.

Komunat kanë përgjegjësi të madhe në krijimin e mjedisit në të cilën personat me handikap do të mund të jetojnë jetë normale së bashku me të tjerët. Politikanët dhe punëtorët komunal patjetër të kujdesen Plani për handikap të zbatohet dhe të respektohet. Pushteti lokal duhet seriozisht të ndërmerret për çështjen e handikapurit, ndërsa si bazë duhet të merren rregullat standarde të Kombeve të Bashkuara për mundësi të barabarta.

## II. Çka është Plani aksionar lokal për çështjen handikap?

- Plani aksionar lokal për çështjen handikap është mjet me të cilën hapet çështja për handikap si temë e zakonshme në politikën e bashkësisë sonë.
- Plani aksionar lokal për çështjen handikap është plan për zhvillim dhe zbatim të politikës së caktuar për handikap në nivel lokal.
- Plani aksionar lokal për çështjen handikap është dokument i cili përmban nevoja të identifikuar, zgjedhje, qëllime dhe prioritetet të cilat bashkësia i vendosë para vete me qëllim që të zhvillohet përkatësisht me vlerat e bashkësisë inkluzive.
- Plani aksionar lokal për çështjen handikap e zhvillon pushteti lokal në bashkëpunim me përfaqësuesit e organizatave të personave me handikap dhe palëve tjera të interesuara. I njëjti ka për qëllim bashkësisë ti mundësojë në mënyrë më përkatëse, në pajtueshmëri me resurset e saja, ti kënaqë nevojat e personave me handikap në bashkësi.
- Plani aksionar lokal për çështjen handikap paraqet mënyrë se si të përgjigjet në nevojat e personave me handikap në një bashkësi në mënyrë përkatëse dhe sistemore në pajtueshmëri me resurset dhe me zhvillimin e bashkësisë.
- Plani aksionar lokal për çështjen handikap është dokument i cili është kahëzuar drejt përmirësimit të kualitetit të jetës dhe punës së personave me handikap në një bashkësi. Ai i përfshinë çështjet të cilat janë me rëndësi të madhe për personat me handikap në të gjitha proceset e përfshirjes dhe në të gjitha fushat e funksionimit të bashkësisë.
- Plani aksionar lokal për çështjen handikap paraqet mënyrë se si të përmirësohet bashkësia lokale duke u siguruar të gjithë qytetarëve mundësi të barabarta që të marrin pjesë në jetën sociale dhe në zhvillimin e bashkësisë.
- Plani aksionar lokal për çështjen handikap është përgjigje e pyetjes çka duhet të bëhet që në mënyrë strategjike të përmirësohet kualiteti i jetës së personave me handikap në bashkësinë tonë.

### III. Çka është handikap?

„Handikap është gjendje e cila mund të jetë e shkaktuar nga fatkeqësia, trauma, faktorët gjenetik ose nga sëmundje, e cila mund të ndikon ose ti kufizojë aftësitë e personave. Handikapi mund ta përfshijë ose kufizojë dëgjimin, shikimin, frymëmarrjen, lëvizjen, të folurit ose funksionet intelektuale. Handikapi mund të jetë që shihet, siç është lëndimi i boshtit kurrizor i cili kërkon përdorimin e karrocës invalidore, ose fizikisht i pa dukshëm siç është diabeti, epilepsia, humbja e dëgjimit, pengesa intelektuale ose probleme në të mësuarit.“

**Definicione moderne** (modeli social për handikap) e vlerëson **handikabin si situatë** që rezulton nga raporti **ndërmjet njerëzve dhe mjedisit të tij**. Ashtu, handikapi duhet të llogaritet si koncept relativ që luhatet varësisht nga konteksti dhe momenti. Ajo nuk është situatë statike, por progresive dhe mundet të ndryshojë duke ju falënderuar zhvillimit të qëndrimeve dhe adaptimit të mjedisit jetësor.

**Do të thotë, handikapi është prodhim i raportit ndërmjet personave dhe mjedisit të tyre jetësor.**

### IV. Modeli social për handikap

„Modeli social” për handikap kërkon ndryshime në vlerat dhe praktikën shoqërore me qëllim që të mënjanohen barrierat për participim të plotë të personave me handikap. Modelin social e kanë përpiluar organizata e personave me handikap të cilat vlerësojnë se modeli medicinal (sipas së cilës personat llogariten si pacientë të cilët duhet të mjekohen) nuk jep sqarime përkatëse për përjashtimin e tyre nga rrjedhat e rregullta të jetës shoqërore. Përvojat e tyre tregojnë se pjesa më e madhe e problemeve nuk del nga handikapi i tyre, por nga jo organizimi i shoqërisë dhe barrierave të cilat i vendosë i njëjti. Si barriera në të cilat ndeshen personat me handikap mund të përmenden këto:

- Paragjykime dhe stereotipe;
- Informacione jo të kapshme;
- Objekte të papërshtatshme; dhe
- Transport i papërshtatshëm.

Këto barriera nuk kanë kurrfarë lidhje me karakteristikat individuale të personave. Barrierat i krijon faktori njeri, kurse ajo do të thotë se munden që ti mënjanojë. Është e qartë se mund diçka të ndryshojë, kurse punët më kanë filluar të lëvizin nga vendi i tyre – për shembull ndërtohen akcese të përshtatshme, informacionet janë të kapshme në shkrimin e Braevit, veb faqe edhe më shumë bëhen të kapshme. Shoqëria pa barriera do të ketë dobi më të madhe, nëse të gjithë qytetarët e saj marrin pjesë dhe kontribuojnë në mënyrë të barabartë.

## **V. Principet e planifikimit aksionar lokal për çështjen handikap**

- Respektimin e të drejtave të personave me handikap si të drejta njerëzore
- Personat me handikap duhet të jenë të njihen në shoqëri si persona të cilat kanë vlera dhe të cilët mund të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë.
- Personat me handikap kanë të drejtë të jenë të konsultuar kur zgjidhet diçka në emër të tyre, që do të thotë duhet të respektohet motoja botërore e organizatave të personave me handikap **ASGJË PËR NE PA NE**.
- Personat me handikap kanë të drejtë të jenë të respektuar sikur edhe të tjerët në shoqëri për të mundur lirisht ti tregojnë aftësitë e tyre intelektuale, sociale, fizike, emocionale, seksuale dhe punuese.
- Personat me handikap kanë të drejtë të kenë qasje dhe të japin kontributin e tyre në të gjitha shërbimet servitore siç atë e kanë edhe anëtarët tjerë të shoqërisë.
- Personat me handikap kanë të drejtë të arsimohet në procesin e rregullt arsimor, ndërsa mos të jenë të ndarë nga shokët e tyre për shkak handikapit të tyre.

## **VI. Të dhënat gjenerale për komunën Çair**

Komuna Çair është komunë e re e formuar dhe përfshin sipërfaqe prej 3.52 km<sup>2</sup> dhe shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë ose në pjesën verilindore të qytetit të Shkupit.

Numri i përgjithshëm i popullsisë në korniza të komunës, sipas regjistrimit të vitit 2002 është 64.773 banorë ose 3,2% nga numri i përgjithshëm i banorëve të Republikës së Maqedonisë. Komuna Çair është komunë multinacionale me 57% Shqiptarë, 24.13% Maqedonas, Turq, Rom, Boshnjak, Serb, Vlleh etj.

Arsimi parashkollor dhe fillor në komunë dekorohen me shkallë të lartë realizimit të procesit fillor mësimor.

## **VII. Vizioni i Komunës Çair**

Nevojat e qytetarëve të kenë pasqyrë gjithëpërfshirëse për karakteristikat e komunës Çair, si komunë e re urbane dhe administrative në korniza të qytetit të Shkupit, e nxit komunën me ndihmën nga USAID-i të bëjë profil të komunës Çair. Pas profilit të bërë i cili shërben si burim i të dhënave dhe informatave për karakteristikat socio-ekonomike të komunës, por edhe si analizë e thellë dhe gjithëpërfshirëse e cila shërben si bazë për përpilimin e strategjisë për komunën Çair.

Në strategjinë dhe në planin e përpiluar aksionar, Komunën Çair e shohim si mjedis bashkëkohor modern dhe mjedis të mirë të ekipuar urbano-administrative.

Janë përpiluar plane aksionare, ndërsa disa janë në fazë të përpilimit dhe me korniza dhe qëllime të dhëna për veprim, komuna synon kah qëllimi i saj.

## **VIII. Pse Komuna Çair zhvilloi plan aksionar lokal për çështjen handikap**

Komuna Çair obligohet se do ta ndjekë konceptin të cilin e promovojnë shoqatat e personave me handikap “Mundësitë të barabarta për jetë të pavarur ” dhe ti përkrahë të drejtat themelore njerëzore me krijimin e planit aksionar lokal për çështjen handikap 2008-2010 i cili do të siguron minimum standarde për kualitet për mundësi servitore dhe të barabarta për të gjithë qytetarët. Zhvillimi, analiza dhe vlerësimi i planit aksionar lokal për çështjen handikap do ti ndihmojë komunës të punojë proaktiv dhe të përgjigjet në nevojat e bashkësisë. Plani aksionar lokal për çështjen handikap është bazuar në Rregullat Standarde për Kombet e Bashkuara (të miratuara nga Kuvendi gjeneral i Kombeve të Bashkuara në vitin 1993) për Mundësi të Barabarta të Personave me Handikap, rregull politike dhe morale e cila synon që ti garantojë të drejtat të të gjitha personave me handikap

## **IX. Si u zhvillua plani aksionar lokal për çështjen handikap**

Me qëllim që të përmirësohen kushtet për jetë të personave me handikap në Komunën Çair, Shoqata e Invalidëve “Shpresa” në bashkëpunimin partner me organizatat tjera të personave me handikap, organizatat joqeveritare dhe “Handicap International” e nxitën krijimin e Planit Aksionar Lokal për çështjen handikap i cili do të bazohet në Rregullat Standarde të Kombeve të Bashkuara.

Hapi i parë në procesin e krijimit të grupit punues i përbërë nga përfaqësuesit e sektorit publik, privat dhe qytetar, ku bashkësia dhe pushteti lokal së bashku do të punojnë që të ndërtojnë plan aksionar i cili do t’ju përgjigjet nevojave të personave me handikap. Ky grup punonte së bashku për ta vlerësuar gjendjen momentale, resurset e kapshme dhe serviset e nevojshme të cilët do të përpilojnë Plan aksionar lokal për çështjen handikap në komunën Çair.

Me qëllim që ti silllet Plan aksionar lokal për çështjen handikap më efektiv, grupi punues u trajnua nëpërmjet pesë moduleve të trajnimit.

Temat e trajnimit ishin: “Konceptet e të drejtave njerëzore themelore” “Qasje e bazuar në bazë të së drejtave njerëzore për Planifikimin e zhvillimit lokal”, “Inkuadrimit e çështjes handikap në politikën lokale”, “Zhvillim i Planit aksionar lokal për handikap”

Pas pesë moduleve të trajnimit, grupi punues kaloi nëpër një varg punëtori me qëllim që të përpilojë Plan aksionar lokal për çështjen handikap

## **X. Monitorim dhe Evoluim të Planit lokal aksionar për çështjen handikap**

Plan aksionar lokal për çështjen handikap do të vlerësohet nëpërmjet:

- Analizës vjetore të Plan aksionar lokal;
- Mbledhjet e rregullta të grupit punues të cilët punojnë në planin aksionar lokal për çështjen handikap;
- Analiza do të përfshijë zhvillim të rezultateve matëse që në fund do të caktojë a janë arritur rezultatet e pritura nga Plani aksionar lokal për çështjen handikap.
- Raport vjetor deri te Këshilli i Komunës për implementimin e Planit aksionar lokal për çështjen handikap.
- Formim i një trupi koordinues nga përfaqësues të komunës dhe sektorit qytetar i cili do t'i koordinojë projektet për realizimin e planit aksionar

## **XI. Lista e problemeve të identifikuara nga grupi punues – Komuna Çair**

### **Ngritja e vetëdijes publike**

Informim jo i mjaftueshëm i qytetarëve

Mospasja kuptim dhe përkrahje për problemet e personave me handicap

Mospasja mundësi e qytetarëve që ti shprehin qëndrimet e tyre

Shpallja dhe përfaqësimi jo i mjaftueshëm i problemeve në medime

### **Barrierat e arkitekturës**

Mospasje qasje deri te institucionet arsimore (çerdhe, shkolla fillore dhe të mesme)

Mospasje qasje deri te të gjitha institucionet shëndetësore

Mospasje qasje deri te posta, banka dhe ndërtesa komunale

Mospasje e qasjes deri te teatri i kombësive, teatri i fëmijëve

Infrastruktura e gjitha trotuareve dhe mbikalimeve

Mospasje e semaforëve me sinjalizim të zëshëm nëpër udhëkryqe

Mospasje e qasjes deri te objektet hotelierike

Pikënisje të pa adaptuara (të pa përshtatura) të autobusëve

Shënimi jo i mjaftueshëm i vend parkingjeve

### **Qasje deri te informacionet**

Ueb faqja e Komunës Çair nuk është e kapshme për persona me dëmtim të shikimit.

Publikimet ekzistuese nuk janë të kapshme për të gjitha personat me handicap

Mos shfrytëzimi i gjuhës gestikulare dhe alfabetit Braev në medimet

Mosekzistimi i zyrës informative për qytetarë

### **Shërbimet servitore**

Mospasje e një qendre njëditore për fëmijë dhe të rinj me nevojë për kurim dhe kujdes plotësues

Mospasje e zyrës për shërbimet sociale dhe servitore

Mospasje kohezion të aktiviteteve ekzistuese të OJQ-ve në komunë (bashkëpunimi jo i mjaftueshëm në mes OJQ-ve nga komuna dhe mosshfrytëzimi i resurseve ekzistuese)

Mospasje e iniciativës nga Sektori joqeveritar për bashkëpunimin me komunën.

Mospasje e standardeve dhe rregullativave për udhëheqje me shërbimet servitore nga ana e OJQ-ve, ndërsa nën mbikëqyrje të komunës.

### **Punësimi**

Informata të pamjaftueshme për personat e aftë për punë, persona me handicap për privilegjet gjatë punësimit.

Informata të pamjaftueshme për punëdhënësit (biznes sektori dhe institucionet qeveritare)

Mosekzistimi i data bazës për të dhënat e nevojshme për punësim për të gjitha sektorët.  
Mosshfrytëzimi i fondeve për rikualifikim  
Mospasje vende të adaptuara të punës dhe pajisje përkatëse për punën dhe mbrojtjen e personave me handikap

### **Arsimi**

Institucione të papërshtatshme arsimore  
Mungesë e kuadrit profesional dhe materialit didaktik në shkolla  
Trajnim jo i mjaftueshëm dhe jo përkatës i mësimitdhënësve të punojnë me persona me handikap  
Komunikim jo i mjaftueshëm i prindërve dhe institucioneve përgjegjëse  
Mosekzistimi i organizuar i transportit të përshtatshëm  
Fushatë jo e mjaftueshme për ngritjen e vetëdijes publike me fëmijët.



## XII. Prioritetizimi i problemeve nga grupi punues

Problem	Kriteret								Gjithsej	Regjistrimi
	Vëllimi	Intensiteti	Ndikimi ndaj problemeve tjera	shpenzime	Mendimi publik	Niveli i kontrollit në Komunë	Kërkesa të planifikuara dhe ligjore rregullative	Mendimet e anëtarëve të komunitetit		
<b>Ngritja e vetëdijes publike</b>										
Informimi jo i mjaftueshëm i qytetarëve	5	4	5	4	3	3	5	5	<b>34</b>	<b>1</b>
Mospasja kuptim dhe përkrahje për problemet e personave me handicap	2	2	2	5	2	1	4	2	<b>20</b>	<b>4</b>
Mospasja mundësi qytetarët ti shprehin qëndrimet e tyre	4	2	4	3	2	2	4	2	<b>23</b>	<b>3</b>
Shpallja dhe përfaqësimi jo i mjaftueshëm i problemeve në medime	4	5	4	4	4	2	2	5	<b>30</b>	<b>2</b>
<b>Qasje deri te informacionet</b>										
Ueb faqja e Komunës Çair nuk është e kapshme për persona me dëmtim të shikimit	3	3	4	4	2	5	1	4	<b>26</b>	<b>4</b>
Publikimet ekzistuese nuk janë të kapshme për të gjitha personat me handicap	5	5	4	2	4	5	4	4	<b>33</b>	<b>1</b>
Mosshfrytëzimi i gjuhës gjestigulare dhe alfabetit Braev në medime	5	4	4	4	3	2	4	4	<b>30</b>	<b>2</b>

Problem	Kriteret								Gjithsej	Regjistrimi
	Vëllimi	Intensiteti	Ndikimi ndaj problemeve tjera	shpenzime	Mendimi publik	Niveli i kontrollit në Komunë	Kërkesa të planifikuara dhe ligjore rregullative	Mendimet e anëtarëve të komunitetit		
Mosekzistimi i zyrës informative për qytetarët	4	3	3	4	3	4	3	4	28	<b>3</b>
<b>Barrierat e arkitekturës</b>										
Mospasje qasje deri te institucionet arsimore (çerdhe, shkolla fillore dhe të mesme)	5	5	5	3	5	5	5	5	38	<b>1</b>
Mospasja e qasjes deri te institucionet shëndetësore	5	5	3	3	3	3	4	4	30	<b>5</b>
Mospasja e qasjes deri te posta, bankat dhe ndërtesa komunale	5	4	4	2	3	4	4	4	30	<b>5</b>
Mospasje qasje deri te teatri i kombësive, teatri i fëmijëve	4	3	3	4	3	4	3	4	28	<b>7</b>
Infrastruktura e të gjitha trotuareve dhe mbikalimeve	5	5	4	5	4	5	4	5	37	<b>2</b>
Mospasja e semaforëve me sinjalizim të zëshëm nëpër udhëkryqe	5	4	3	5	4	5	4	4	34	<b>4</b>
Mospasje qasje deri te objektet hoteliere	3	2	2	5	2	5	4	3	26	<b>9</b>
Pikënisje të pa adaptuara (të papërshtatshme) të autobusëve	5	5	5	4	4	4	4	5	36	<b>3</b>

Problem	Kriteret								Gjithsej	Regjistrimi
	Vëllimi	Intensiteti	Ndikimi ndaj problemeve tjera	shpenzime	Mendimi publik	Niveli i kontrollit në Komunë	Kërkesa të planifikuara dhe ligjore rregullative	Mendimet e anëtarëve të komunitetit		
Shënime të pamjaftueshme të vend parkingjeve	4	3	3	4	2	3	5	3	27	8
<b>Shërbimet servimore</b>										
Mospasja e qendrës ditore për fëmijë dhe të rinj me nevojë për kurim dhe kujdes plotësuese	5	5	4	2	3	4	4	4	31	3
Mospasje e zyrës për shërbimet sociale dhe servimore	5	4	5	2	5	4	4	5	34	1
Mosekzistimi i kohezionit të aktiviteteve ekzistuese të OJQ-ve në komunë (bashkëpunimi jo i mjaftueshëm në mes OJQ-ve dhe komunës dhe mosshfrytëzimi i resurseve ekzistuese)	4	3	4	5	1	2	1	5	25	5
Mosekzistimi i iniciativave nga Sektori joqeveritar për bashkëpunim me komunën	4	4	4	5	3	3	4	5	32	2

Problem	Kriteret								Gjithsej	Regjistrimi
	Vëllimi	Intensiteti	Ndikimi ndaj problemeve tjera	shpenzime	Mendimi publik	Niveli i kontrollit në Komunë	Kërkesa të planifikuara dhe ligjore rregullative	Mendimet e anëtarëve të komunitetit		
Mosekzistimi i standardeve dhe rregullativave për udhëheqje me shërbimet servitore nga ana e OJQ, ndërsa nën mbikëqyrje të komunës	5	4	5	3	3	4	1	4	<b>29</b>	<b>4</b>
<b>Punësimi</b>										
Informata të pamjaftueshme për personat e aftë për punë, persona me handicap për privilegjet gjatë punësimit	4	5	5	1	5	3	5	5	<b>31</b>	<b>1</b>
Informata të pamjaftueshme për punëdhënësit (biznes sektori dhe institucionet qeveritare	4	5	5	1	5	3	5	5	<b>31</b>	<b>1</b>
Mosekzistimi i data bazës për të dhënat e nevojshme për punësim për të gjithë sektorët	4	5	4	3	3	2	3	4	<b>29</b>	<b>3</b>
Mosekzistimi i fondeve për rikualifikim	4	4	4	5	3	3	3	4	<b>26</b>	<b>5</b>

Problem	Kriteret								Gjithsej	Regjistrimi
	Vëllimi	Intensiteti	Ndikimi ndaj problemeve tjera	shpenzime	Mendimi publik	Niveli i kontrollit në Komunë	Kërkesa të planifikuara dhe ligjore rregullative	Mendimet e anëtarëve të komunitetit		
Mospasja vendeve të adaptuara të punës dhe pajisjes përkatëse për punë dhe mbrojtje të personave me handikap	4	4	3	2	3	2	4	4	26	<b>5</b>
<b>Arsimi</b>										
Institucione të papërshtatshme arsimore	5	5	5	1	4	4	5	5	34	<b>1</b>
Mungesë të kuadrit profesional dhe materialeve didaktike në shkolla	3	4	4	3	4	3	4	4	29	<b>2</b>
Trajnim i pamjaftueshëm dhe i jo përkatës i arsimtarëve të punojnë me persona me handikap	4	4	4	2	4	4	3	4	29	<b>2</b>
Komunikim i pamjaftueshëm i prindërve dhe institucioneve përgjegjëse	3	4	4	5	3	1	1	4	25	<b>5</b>
Mosekzistimi i transportit të organizuar të përshtatshëm	4	4	4	1	4	4	3	5	29	<b>2</b>
Fushatë jo e mjaftueshme për ngritjen e vetëdijes publike me fëmijët	4	4	4	3	3	1	1	4	24	<b>6</b>

### XIII. Plani Aksionar Lokal – Tabela për Implementim

#### 1. Fusha prioritare: Ngritja e vetëdijes publike

Qëllimet	Strategji / aktivitete	Korniza kohore	Institucioni përgjegjës	Treguesit e suksesit	Resurset e nevojshme
Informim i qytetarëve për problemet e personave me handikap në Komunën Çair	Animimi i gazetarëve për problemin e personave me handikap në komunën Çair	Janar 2008 - Mars 2008 Janar 2009 - Mars 2009 Janar 2010 – Mars 2010	Organizatat e personave me handikap nga Çairi Komuna Çair	Numri i teksteve të botuara në muaj Temat të cilat do të trajtohen në tekstet	Resurse njerëzore – vullonterë Materiale në dispozicion dhe informacione për temat
	Fushatë për problemet e personave me handikap për qytetarët, afaristët dhe politikanët	Mars 2008 – Dhjetor 2008	Organizatat e personave me handikap nga Çairi Komuna Çair	Numri i personave të përfshirë në fushatë Reagimi i qytetarëve Numri i afaristëve të interesuar	Resurse njerëzore dhe financiare (donatorë + Komuna Çair)
	Organizim i ngjarjeve publike	Shtator - Dhjetor 2008	Organizatat e personave me handikap nga Çairi Komuna Çair	Vizita e ngjarjeve Reagimi i qytetarëve	Hapësirë, resurse njerëzore dhe financiare (donatorë + Komuna Çair)
	Fushatë e ngritjes së vetëdijes publike të fëmijëve pa handikap	Shtator 2008 - Qershor 2009	Organizatat e personave me handikap nga Çairi Komuna Çair Mediumet	Numri i fëmijëve të përfshirë Reagimi i fëmijëve pa handikap	Hapësirë, resurse njerëzore dhe financiare (donatorë + Komuna Çair)

## 2. Fusha prioritare: Barrierat e arkitekturës

Qëllimet	Strategji / aktivitete	Korniza kohore	Institucioni përgjegjës	Treguesit e suksesit	Resurset e nevojshme
Qasje e mundësuar fizike të personave me handicap deri te të gjitha institucionet publike në territorin e Komunës Çair	Sjellja e rregullativës për eliminimin e barrierave të arkitekturës në territorin e Komunës Çair	Janar - Maj 2008	Këshilli i komunës	Aktet e sjella	
	Qasje deri te institucionet arsimore (çerdhe, shkolla fillore dhe të mesme)	Qershor 2008 – Shtator 2010	Institucione arsimore	Eliminimi i barrierave të arkitekturës Numri i personave me handicap të cilët e vizitojnë objektin Kualiteti i qasjes	Resurset financiare (komuna dhe donatorë)
	Qasje deri te të gjitha institucionet shëndetësore	Qershor 2008 – Shtator 2010	Institucionet shëndetësore	Eliminimi i barrierave të arkitekturës Numri i personave me handicap të cilët e vizitojnë objektin Kualiteti i qasjes	Resurset financiare (mjete personale dhe donatorë)
	Qasje deri te posta, bankat dhe ndërtesa komunale	Qershor 2008 – Shtator 2010	Institucione përgjegjëse	Eliminimi i barrierave të arkitekturës Numri i personave me handicap të cilët e vizitojnë objektin Kualiteti i qasjes	Resurset financiare (mjete personale, komuna dhe donatorë)
	Qasje deri te teatri i kombësive, teatri i fëmijëve	Qershor 2008 – Shtator 2010	Institucione përgjegjëse	Eliminimi i barrierave të arkitekturës Numri i personave me handicap të cilët e vizitojnë objektin Kualiteti i qasjes	Resurse financiare (Ministria e kulturës dhe donatorë)

Infrastruktura i të gjitha trotuareve dhe mbikalimeve	Shtator 2008 - Qershor 2009	Komuna Çair	Eliminimi i barrierave të arkitekturës Kualiteti i qasjes	Resurse financiare (Komuna dhe donatorë)
Semaforë me sinjalizim të zëshëm nëpër udhëkryqe	Qershor 2008 - Maj 2009	Komuna Çair	Numri i semaforëve me sinjalizim të zëshëm	Resurse financiare (Komuna dhe donatorë)
Qasje deri te objektet hoteliere	Rrjedhimisht deri më 2010	Pronarët e objekteve	Numri i objekteve me qasje Kualiteti i qasjes	Mjete personale
Pikënisje të adaptuara (të papërshtatshme) të autobusëve	Shtator 2008 - gusht 2009	NPK+ transportuesit privat	Eliminimi i barrierave të arkitekturës Kualiteti i qasjes	Resurse financiare (mjete personale dhe donatorë)
Shënim i mjaftueshëm i vend parkingjeve	Rrjedhimisht deri më 2010	Komuna Çair	Numri i vend parkingjeve të shënuara	Resurse financiare (pronarët e objekteve ,Komuna dhe donatorë)



### 3. Fusha prioritare: Qasje deri te informatat

Qëllimet	Strategji / aktivitete	Korniza kohore	Institucioni përgjegjës	Treguesit e suksesit	Resurset e nevojshme
Zhvillimi dhe implementimi i veglave për komunikim të cilët mundësojnë qasje deri te informacionet për personat me handikap në Komunën Çair	Përshtatja e ueb faqes të komunës Çair që të jetë e kapshme për persona me dëmtim shikimi	Janar - Qershor 2008	Komuna Çair	Kapshmëria e ueb faqes Numri i vizitorëve me dëmtim shikimi në ueb faqen e kapshme	Vollonterë
	Përshtatja e publikimeve ekzistuese për persona me shikim të dëmtuar (audio format në CD ose fond më të madh)	Rrjedhimisht deri më 2010	Komuna Çair	Kapshmëria e publikimeve Numri i shfrytëzuesve me dëmtim të shikimit	Resurset ekzistuese
	Shfrytëzimi i rritur i gjuhës gjestikulare dhe belbëzimi në mediume	Rrjedhimisht deri më 2010	Shtëpitë e mediave Organizatet joqeveritare	Numri i emisioneve në të cilat shfrytëzohet gjuha gjestikulare dhe belbëzimi	Mjete financiare (mediume dhe donatorë)
	Hapja e zyrës informative dhe servitore për qytetarët	Janar –mars 2008	Komuna Çair	Numri i shfrytëzuesve të zyrës	Hapësirë, mjete financiare dhe resurse njerëzore (Komuna dhe donatorë)

#### 4. Fusha prioritare: Shërbimet servitore

Qëllimet	Strategji / aktivitete	Korniza kohore	Institucioni përgjegjës	Treguesit e suksesit	Resurset e nevojshme
Shërbime të mundësuar direkt të personave me handikap dhe familjeve të tyre	Hapja e qendrës njëditore për fëmijë dhe të rinj për kurim dhe kujdes plotësues	Janar 2008 - Dhjetor 2010	Komuna Çair	Funksionimi i qendrës Numri i fëmijëve të përkujdesur Kualiteti i shërbimeve	Hapësirë, resurse financiare dhe resurse njerëzore (ministria për punë dhe çështje sociale, UNICEF, Komuna Çair)
	Rritja e bashkëpunimit në mes OJQ nga komuna dhe shfrytëzimi më efikas i resurseve ekzistuese	rrjedhimisht	Organizatrat joqeveritare dhe komuna	Memorandum për bashkëpunim Numri i iniciativave të realizuara bashkërisht Numri i partneriteteve të formuara, koalicione	
	Përforcimi i iniciativës nga Sektori joqeveritar për bashkëpunim me komunën	Deri më qershor 2008	Organizatrat joqeveritare dhe komuna	Memorandum për bashkëpunim Numri i iniciativave të realizuara bashkërisht Numri i partneriteteve të formuara, koalicione	
	Përcaktimi i kriterëve për udhëheqjen me shërbimet servitore nga ana e OJQ-ve, ndërsa nën mbikëqyrje të komunës	Janar - Dhjetor 2009	Komuna Çair	Kriteret e sjella Numri i shërbimeve të cilat i realizojnë OJQ-të Kualiteti i shërbimeve të cilat i japin shërbimet servitore	Standarde të sjella nga ana e Ministrisë për PPS Resurse njerëzore

## 5. Fusha prioritare: Punësimi

Qëllimet	Strategji / aktivitete	Korniza kohore	Institucioni përgjegjës	Treguesit e suksesit	Resurset e nevojshme
Numri i rritur i personave të punësuar me handikap	Informimi i personave të aftë për punë, persona me handikap	Mars - Dhjetor 2008	Organizatat joqeveritare dhe komuna	Regjistrimi i personave të aftë për punë Numri i të punësuarve, persona me handikap	Resurse financiare dhe njerëzore (komuna dhe donatorë)
	Informim i punëdhënësve (biznes sektori dhe institucionet qeveritare)	Mars – Dhjetor 2008	Organizatat joqeveritare dhe komuna	Regjistrimi i personave të aftë për punë Numri i personave me handikap të punësuar Numri i punëdhënësve potencial të interesuar	Resurse financiare dhe njerëzore (komuna dhe donatorë))
	Krijimi i data bazës për të dhënat e nevojshme për punësim për të gjitha sektorët	Janar 2009 - Dhjetor 2009	Zyra informative servitore për qytetarët	Numri i personave të regjistruar me handikap Numri i shfrytëzuesve	Developer dhe Administrator i bazës
	Shfrytëzimi më i madh i fondeve për rikualifikim	Qershor 2009 - Dhjetor 2010	Zyra informative servitore për qytetarët + OJQ	Numri i rikualifikuar i personave me handikap Përqindja e shfrytëzimit të fondeve	Resurse njerëzore
	Adaptimi i vendit të punës dhe pajisja përkatëse për punë dhe mbrojtje të personave me handikap	Mars 2008 - Dhjetor 2010	Biznes sektori, institucionet publike OJQ-të	Numri i vendeve përkatëse të adaptuara	Mjete financiare dhe vullnet

## 6. Fusha prioritare: Arsimi

Qëllimet	Strategji / aktivitete	Korniza kohore	Institucioni përgjegjës	Treguesit e suksesit	Resurset e nevojshme
Arsimi inkluziv	Ritrajnimi i kuadrit profesional për punë me fëmijët me handikap	Janar 2008 - Dhjetor 2010	Departamenti për arsim	Numri i kuadrit të ritrajnuar Kënaqësia e nxënësve	Resurset financiare (Donatorë dhe ministria për arsim dhe shkencë, MPPS)
	Intensiteti i komunikimit në mes prindërve dhe institucioneve përgjegjëse	Mars 2008 - Dhjetor 2010	OJQ-të Shkollat Departamenti për arsim	Numri i mbledhjeve dhe takimeve Numri i fëmijëve me handikap të cilët janë përfshirë në arsimin e rregullt sipas standardeve për moshën	Resurse njerëzore
	Vendosje e transportit të organizuar të përshtatur	Janar 2009 - Dhjetor 2010	OJQ-të dhe komuna	Numri i shfrytëzuesve të transportit	Resurse financiare (donatorë, NPK)

## **XIV**

Ky Plan aksionar hynë në fuqi me ditën e sjelljes, ndërsa do të shpallet në  
“Fletën zyrtare të Komunës së Çairit”

Nr. 07-1323/6  
prej datës 17.12.2007  
S h k u p

KËSHILLI I KOMUNËS SË ÇAIRIT  
KRYETAR,  
Musa Zuka, d.v.